



MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE
SEKTORI I ZBATIMIT TË POLITIKAVE, PROJEKTEVE DHE STRATEGJIVE

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
Viti 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	27.01.2025	Kërkesë për informacion mbi dosjen e shtetasit A. K	27.01.2025	Në vijim të e-mailit tuaj, një e-mail sqarues mbi situatën e z. A. K i është dërguar Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë. Me e-mailin e datës 21.01.2025, specialist/juriste e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë ka kthyer përgjigje, si më poshtë vijon: <i>“Përshëndetje ! Duke uruar të jeni mirë! Z. A. K është paraqitur pranë Qshnjp Korçë në datën 13.03.2023, me kërkesë për ndihmë juridike dytësore, kategori e veçantë përfitues i skemës sociale, për çështjen me objekt vërtetimi i atësisë për fëmijen lindur jashtë martese. Ka përfutuar ndihmë</i>	E plotë	Nuk ka

			<p><i>juridike dytësore, si proçes i është zgjatur për arsye se gjyqtarja e parë që kishte çështjen u largua, gjyqtari i dytë nuk e kaloi vettingun. Pasi u zbardh vendimi çështja i ka kaluar avokate E.H, e cila i ka përgatitur edhe kërkesë padinë për në gjykatë. Në çështjen e Z. A. K ka një problem të tillë përpara se t'i drejtohej Ndhmës Juridike, i është drejtuar Tlas në vitin 2022, duke qenë se nuk mori përgjigje vazhdoi procedurën në Qshnjp Korçë. Aktualisht çështja e tij po trajtohet edhe nga Tlas edhe nga avokatja e listes tonë.</i></p> <p>Gjithashtu, referuar protokollit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, konstatohet se z. A. K i është drejtuar Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me kërkesën Nr.18 Prot, datë 06.01.2025, ku bashkëlidhur është kërkesë-padia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përgatitur nga avokate E.H, avokate e listës së ndihmës juridike.</p> <p>Në këto kushte procedura përpara i përket marrjes së çështjes nga avokati i listës së ndihmës juridike falas është ezauruar dhe avokate E.H e ka dorëzuar Kërkesë-padinë, me paditës A. K, i paditur J.R, person i tretë J.Sh, me objekt Vërtetim njohje atësie, kundërshtimin e atësisë së prezumuar, detyrimin e gjendjes civile të regjistrojë vajzën me atësi dhe mbiemër paditësin A. K dhe rivendojse në afat për ngritjen e padisë, protokolluar nga gjykata në datën 30.12.2024. Mbi situatën e dosjes së z. A. K në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk kemi më tepër informacion.</p> <p>Sa më sipër, lutem Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Korçë t'i drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për t'u informuar mbi situatën e dosjes së z. A. K, duke kërkuar një përsheptim të gjykimit të çështjes, për arsye që ndikojnë në arsimimin e fëmijës së mitur. Ju informoj se kërkesë-padia ka datën e</p>		
--	--	--	--	--	--

				depozitimit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, 30.12.2024.		
2	03.02.2025	Kërkesë për informacion mbi ndikimin e pezullimit të financimeve nga SHBA.	04.02.2025	Në vijimësi të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nuk merr financime apo fonde nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.	E plotë	Nuk ka

Përditësimi i fundit i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve **04.03.2025**

Koordinatori për të Drejtën e Informimit

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

Helga Çela